

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 17 NËNTOR 2022

Zonja Tabaku, nga faktet që ju shqetësojnë ju dhe opozitën, duke i dëgjuar, rreshtova 4 prej tyre. Përtej patosit dhe inflacionit të shumë gjërave të thëna, edhe pse po flasim për buxhetin faktik, një gjë është e sigurt, që prezantimi i buxhetit faktik nuk mund të sillet këtu pa raportin e KLSH-së, dhe ju këtë e dini shumë mirë, pavarësisht se nuk i thoni të gjitha të vërtetat siç janë. Nuk besoj se është përgjegjësi e qeverisë nëse raporti i KLSH-së vonohet. Sot vihet pikërisht për këtë arsye dhe buxheti faktik ka qenë gati nga ministria përgjegjëse dhe nga qeveria në kohën e duhur, që në korrik. Ju bëni të gjithë betejën tuaj për të gjitha faktet që ju shqetësojnë, por unë do t'i marr një nga një të katra faktet që ju shqetësojnë.

Së pari, akuzoni për ndryshime të shpeshta në buxhetin e shtetit. Në vitin 2021 janë bërë 6 ndryshime të buxhetit të shtetit, pra 6 akte normative, të cilat nëse nuk do të ishin dhe nuk do të ndodhnin në atë diligence në të cilën ndodhën, nuk do të ishte e mundur të ndihmoheshin me paketa të drejtpërdrejta shtresat në nevojë, por sidomos as të realizohej mbështetja financiare për të përballuar pandeminë. Viti 2021 nuk ishte një vit normal, ju këtë e dini shumë mirë, u përballën të gjithë, si buxheti i shtetit, si familjet shqiptare, ashtu dhe të gjithë individët me një armik, i cili vuri para përgjegjësisë jo vetëm shtimin e buxheteve, por edhe gjetjen e vaksinave, që u bë fakt, dhe asnjëherë nuk e përmirësuar gjuhën tuaj për të vlerësuar këtë element të rëndësishëm.

Absolutisht të 6 aktet normative erdhën në ndihmë për përballimin e situatës së tërmetit, të pandemisë, duke realizuar edhe shkurtime në shpenzimet e panevojshme dhe të porealizuara në kohë, për t'u alokuar aty ku ishte më e nevojshme. Është e rëndësishme të përmend edhe një fakt: asnjë shkurtim në investimet kapitale! Gjithashtu, dua të përmend 138 kontrata të finalizuara totalisht. Këto janë fakte.

Nga këto 138 kontrata të finalizuara, 16 janë kontrata investimi në transport rrugor; 23 kontrata investimi për ujësjellës-kanalizime; 27 kontrata për rikonstruktionet e ambienteve në disa spitale, poliklinika dhe qendra shëndetësore, për furnizim dhe vendosje të pajisjeve spitalore; 41 kontrata investimi për përmirësimin e kanaleve ujitëse në disa zona në Shqipëri (ndërtimi i argjinaturave për lumenjtë dhe mbrojtja e tyre); 8 kontrata investimi për sisteme armatimi, për pajisje individuale ushtarake, për sisteme kompjuterike; 5 kontrata të rëndësishme për rikonstrukcione dhe ndërtime

kopshtesh, shkollash, universitetesh dhe ambiente sportive; 3 kontrata për rehabilitime dhe pyllëzime, për bova ankoruese, për përmirësimin e situatave mjedisore; 2 kontrata projektpilot për përmirësimin e eficiencës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe furnizimit me ujë, si dhe 6 kontrata në fushën kulturore, për rikonstruksione e blerje pajisjesh. Si mendoni? Janë të panevojshme në gjuhën e opozitës? Sigurisht që jo.

Asnjëri nga ju nuk do ta mohonte që këto janë kontrata të domosdoshme për shërbimet optimale në të gjitha fushat. Përveç kësaj, u shtuan të gjitha fondet e nevojshme për përballimin e situatës së pandemisë dhe të tërmetit. Së dyti, ju shqetëson qëndrueshmëria financiare, por duhet t'u referoheni, përtej KLSH-së, edhe raporteve të institucioneve ndërkombëtare, që merren me monitorimin e qëndrueshmërisë financiare. Për tre vjet rresht, të dyja institucionet financiare, ekonominë shqiptare dhe financat publike të Republikës së Shqipërisë i kanë konsideruar të qëndrueshme, dhe këtë, me apo pa dashje, nuk e thoni asnjëherë. Si ekonomiste dhe si anëtare e Komisionit të Ekonomisë ju sugjeroj ta vlerësoni.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, rritja e borxhit, që është një akuzë e përhershme. Është rritur borxhi për të përballuar vështirësitë nga tërmeti dhe pandemia, dhe e kemi aprovuar në këtë parlament të nderuar. Por ku jemi sot? Përpara se të shikojmë se ku jemi sot dhe ku e projektojmë borxhin në vitin 2023, dua të theksoj një element shumë të rëndësishëm: vlera, për të cilën merret ky borxh, ku shkon? Sa investime më shumë janë realizuar në qeverisjen e Kryeministrit Rama në krahasim me atë të PDsë? 3 herë më shumë produktivitet investimesh se në kohën tuaj, nëpërmjet investimeve dhe rritjes së borxhit! Këto janë fakte për të cilat nuk ka KLSH, së cilës ju i bëtë referencë në të gjithë raportin tuaj, por ka ekonomistë dhe statistika që, me shumë mirësjellje, ju këshilloj t'i merrni në referencë dhe të vlerësoni edhe elementet pozitive, përveç demagogjisë dhe përbaltjes.

Të ardhurat e tatimeve dhe doganave janë rritur në vitin 2021, një vit shumë i vështirë e, megjithatë, shumë i suksesshëm për rritjen e të ardhurave, si rezultat i një politike të miradministrit fiskal, i nisur prej vitesh, por edhe falë politikave fiskale. Rritja ekonomike Si mund ta mohoni, kur flisni për buxhetin faktik të vitit 2021, rritjen ekonomike me 8,5% në një vit kaq të vështirë?! Ishte një rritje mbi mesataren e rritjes ekonomike të Ballkanit Perëndimor, edhe pse në vendin e tretë. Të vini e të referoni këtu vetëm të pavërteta, apo ato të vërteta që ju interesojnë juve, është përsëri një demagogji jo prej një ekonomisti.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në buxhetin faktik ka elemente shumë të rëndësishme, që lidhen me borxhin. Trajektorja e borxhit për vitin aktual vjen duke rënë, dhe e projektuar në vitin 2023 ulet më tej në 76,5%. Ky është konsolidimi fiskal, të cilin qeveria shqiptare e ka marrë si angazhim në këtë parlament dhe po e realizon. I fundit, por jo më pak i rëndësishëm, është thellimi i mëtejshëm i decentralizimit fiskal, ku fokusi kryesor është pushteti vendor. Përgjatë gjithë vitit 2021 vazhdimi i konsolidimit dhe menaxhimit financiar në nivel vendor është po aq i rëndësishëm për të vërtetuar edhe një herë se reforma administrativo-territoriale ishte e domosdoshme dhe e nevojshme për të përmirësuar financat e pushtetit vendor me rritje të të ardhurave, por edhe të zërave të shpenzimit.

Ka një të vërtetë të padiskutueshme në raportin në Komisionin e nderuar të Integritetit, të cilin ju e drejtoni. Në progresraportin për të cilin sot u fol gjerësisht për mbi 4 orë theksohet: “Shqipëria ka bërë përparim të mirë dhe është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie tregu funksional, në sajë të një korpusi politikash kryesisht të përshtatshme. Ekonomia shqiptare tregoi elasticitet dhe e rimori veten më shpejt se pritshmëritë në vitin 2021, duke fshirë shumën e humbjeve ekonomike të shkaktuara nga pandemia Covid-19. Është bërë progres i mirë me reformat e lidhura me të ardhurat, edhe pse ka akoma shumë punë për pjesën e ekonomisë informale”.

Prandaj duhet përgjegjshmëria e çdo deputeti, pavarësisht se nga cila anë qëndrojmë dhe pavarësisht se nuk do të jemi asnjëherë dakord për buxhetin. Shifrat dhe faktet për ata që janë ekonomistë dhe, mbi të gjitha, anëtarë të Komisionit të Ekonomisë mbeten të vërteta për t’u ballafaquar jo vetëm mes nesh dhe me debate shpeshherë të kota, por mbi të gjitha me qytetarët. Faleminderit!